

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA /
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
 MINISTRIA E EKONOMISË
 MINISTARSTVO EKONOMIJE
 MINISTRY OF ECONOMY

Njesia Org. 01/3 Nr. Prof. 1667
 Org. Jedln Br. Prof. Prof.No:
 Org Unit Nr. i faqeve 31.08.26
 Nr. i faqeve Datum:
 Broj stranica Date:
 No. pages PRISHTINE/A NO.1

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE
 »HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.

Nr. 4900
 Dt. 26.08. 2026
 PRIZREN



KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizren

Adresa: Wesly Clark p.n., 20000 Prizren
 email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Bordi i Drejtorëve në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh. A. me seli në Prizren, në përputhje me Nenin 31(31.2) për raportet tremujore të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe nenin 18 të Ligjit Nr.04/L -111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.08.2026, mori këtë:

VENDIM

RAPORTI - TM2 - 2026

Bordi i Drejtorëve në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh. A, miratoi Raportin e TM2 për vitin 2026, në mbledhjen e mbajtur me 26.08.2026.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv Bekim Gashi	Kryesuesi i BD Ylber Elshani
Nënshkrimi		
Data	26.08.2026	



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISË MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njësia Org. Org. Jedin Org. Unit	Nr. Prof. Br. Prof.
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	Datum Date
01/3	1667
-	31.08.26
PRISHTINË/A	NO.1

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE	
»HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.	
Nr.	4900
Dt.	26.08 2026
PRIZREN	

RAPORT – TM2 2026


TM2 – 2026 -KRU "HIDROREGJIONI JUGR" SH.A. – PRIZREN

Përmbajtje

ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE	3
I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	4
1.1 Aktivitetet kryesore	4
1.2 Të arriturat kryesore	6
1.3 Problemet që kanë ndikuar në realizimin e objektivave	7
1.4 Masat e propozuara	8
2 DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES	8
2.1 Situata e furnizimit	8
2.2 Aktivitetet kryesore	10
2.3 Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së – TM2- 2026	12
2.4 Cilësia e ujit të pijes	13
3 DEPARTAMENTI KOMERCIAL	14
3.1 Aktivitetet kryesore	14
3.1.2 Inspektimi dhe Shkqçja	16
4 DEPARTAMENTI I FINANCAVE	16
4.1 Aktivitetet kryesore	16
4.2.1 Arsyeshmëria e shpenzimeve	17
5 DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA	19
4.1 Aktivitetet e përgjithshme	19
VI. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	25
6.1 Aktivitetet kryesore	25
VII. PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE	31
7.1 NJ.P- PRIZREN – TM2- 2026	31
7.2 NJ.P- SUHAREKË – TM2- 2026	32

7.3	NJ.P- DRAGASH – TM2- 2026.....	33
7.4	NJ.P- MALISHEVË – TM2- 2026.....	34
7.4	KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” Sh.A– TM12 2026.....	35
7.4	REALIZIMI I CAQEVE - KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” -TM2- 2025-2026	36
VIII.	AKTIVITETET E PROKURIMIT	37
IX.	MENAXHIMI E RREZIQEVE.....	39
X.	PASQYRAT FINANCIARE	42
XI.	ORGANOGRAMI.....	45

ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE



I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

1.1 Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës prill – qershor 2026, me të marr mandatin si Kryeshef Ekzekutiv, aktiviteti është fokusuar në mbledhje dhe takime individuale njoftuese dhe informuese me zyrtarët e lartë të kompanisë. Menaxhimin dhe koordinimin e kompanisë, zhvillimin e projekteve prioritare, përmirësimin e infrastrukturës dhe furnizimit me ujë, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe përmirësimin e performancës operative dhe financiare.

Një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve ka qenë e orientuar në monitorimi i situatës së furnizimit dhe performancës së operative dhe financiare. Zhvillimin dhe sigurimin e mbështetjes për projektet investuese, veçanërisht projektin e dislokimit të Rezervuarit të Kalasë në Prizren, projektin e furnizimit me ujë të Malishevës dhe rehabilitimin e rrjetit në rrugën “Hamit Thaçi” (Bingeni). Në këtë kuadër, janë zhvilluar takime me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, ndërsa janë nënshkruar marrëveshjet për financimin e projektit për për dislokimin e rezervuarit të ujit të pijes nga Kalaja e Prizrenit si dhe marrëveshja për ndërtimin e rezervuarit të ri me kapacitet 1,000 m³ dhe instalimin e pompave të reja në Banjë të Malishevës. Gjithashtu, janë dorëzuar 6 projektpropozime në kuadër fondeve të WBIF – Raundit 13 të Granteve Investuese.

Gjatë këtyre tre muajve janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm takimesh të rëndësishme me institucione dhe partnerë strategjik, ndër të cilat:

- Takime me Ministrinë e Ekonomisë, lidhur me projektet prioritare të kompanisë, veçanërisht dislokimin e Rezervuarit të Kalasë dhe projektin e furnizimit me ujë të Malishevës.
- Dislokimi i rezervuarit të Kalasë së Prizrenit:
Më 13 maj 2026, në Kalanë e Prizrenit, u zhvillua vizita e kryeministrit Albin Kurti, ministres së Ekonomisë Artane Rizvanolli ministres së Kulturës Saranda Bogujevci dhe ministrit të Zhvillimit Rajonal Rasim Demiri ku nga afër u prezantua gjendja dhe ndikimi i rezervuarit në strukturën e Kalasë. Gjatë vizitës u mor zotimi për mbështetjen e projektit. Më 21 maj 2026 u nënshkrua marrëveshja e financimit në vlerë prej 450,000 €, ndërsa tashmë kanë filluar procedurat për realizimin e projektit.
- Me 21 maj së bashku me Bordin dhe menaxhmentin e kemi pritur në takim Ministrën e Ekonomisë znj. Artane Rizvanolli, e cila është interesuar për gjendjen financiare, operative, projektet dhe investimet kapitale të kompanisë.
- Furnizimi me ujë i Malishevës:
Më 25 maj 2026, në nënstacionin e pompimit në Banjë, u zhvillua vizita e Kryeministrit Albin Kurti dhe Ministres së Ekonomisë Artane Rizvanolli, ku u prezantua Studimi i Fizibilitetit për furnizimin me ujë të Malishevës dhe nevojat prioritare për investime. Gjatë vizitës u mor zotimi për mbështetjen financiare të projektit. Për vitin 2026 është kërkuar financim prej 315,000 €, për instalimin e pompave të reja dhe ndërtimin e rezervuarit të ri me kapacitet 1,000 m³. Është nënshkruar marrëveshja e financimit, ndërsa tashmë kanë filluar procedurat për realizimin e projektit.
- Takime me ARRU-në, lidhur me auditimin dhe verifikimin e të dhënave të raportuara për vitin 2025 dhe procesin e licencimit të kompanisë.

- Takime me Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, për çështje të planifikimit, investimeve dhe financimit të projekteve prioritare.
- Takim me përfaqësuesit e SUEZ-it, në kuadër të projektit të mbështetur nga Banka Botërore.
- Takime me përfaqësuesit e Programit për Reziliencën Klimatike, me fokus në menaxhimin e humbjeve të ujit (UPF) dhe zhvillimin e zonave DMA.
- Takime me Kryetarin e Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj, për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.
- Takim me Kryetarin e Komunës së Malishevës dhe Kryetarin e Komunës së Mamushës, për çështje të furnizimit me ujë dhe bashkëpunimit institucional.
- Takim me Komandantin Rajonal të Policisë së Kosovës në Prizren, z. Faton Alija, për bashkëpunimin dhe mbështetjen në aktivitetet e kompanisë.
- Takime me përfaqësuesit e mediave lokale, TV Prizreni dhe RTV Besa, për bashkëpunimin në informimin e publikut dhe komunikimin me konsumatorët.
- Takime me partnerë dhe institucione ndërkombëtare, përfshirë aktivitetet e lidhura me Programin Zviceran të Bashkëpunimit dhe projektet e mbështetura nga Banka Botërore.

Gjatë kësaj periudhe është zhvilluar gjithashtu bashkëpunim i vazhdueshëm me SHUKOS-in, përmes pjesëmarrjes në mbledhjet e Bordit dhe në Kuvendin e Anëtarëve, si dhe në takime profesionale me përfaqësues të sektorit të ujërave.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar monitorimit të situatës së furnizimit me ujë dhe gjendjes së burimeve ujore, përmes vizitave në burimet e Cvilenit, Vërmicës, Poslishtit, Sozit dhe "40 Burimeve", si dhe në rezervuarë dhe objekte të tjera të sistemit.

Gjithashtu, janë realizuar vizita në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura në Vlashnje. Vizita në NJP–Malishevë, për të vlerësuar gjendjen e infrastrukturës dhe dëmet e shkaktuara nga rrëshqitjet e dheut.

Në kuadër të forcimit të strukturës organizative dhe menaxheriale të kompanisë:

- është emëruar Drejtori Teknik;
- janë shpallur konkurset për Drejtor Komercial, Menaxher të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Ligjore, si dhe për pozita të tjera;
- është monitoruar performanca operative dhe financiare e njësive organizative;
- janë analizuar mundësitë për investime në makineri dhe pajisje të reja.

Periudha prill–qershor 2026 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv menaxherial, institucional, teknik dhe investues. Përveç menaxhimit të përditshëm të kompanisë, fokusi kryesor ka qenë në sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë, realizimin e projekteve prioritare, sigurimin e financimit, forcimin e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale, si dhe përmirësimin e performancës dhe kapaciteteve të kompanisë.

1.2 Të arriturat kryesore

TM2 - 2026

- Shkyqje të lidhjeve ilegale: 171
- Shkyqje për mos pagesë: 124
- Shkyqje totale: 295
- Përmbarues: 212
- Riprogramim i borgjit: 30
- Bllombime te reja: 514

TM2 -2025- 2026

- | | | |
|--------------------------|---------|----------------------------------|
| • Prodhimi - m3 për | - 11.3% | (- 1,045,339 m3) |
| • Faturimi - m3 për | - 0.5 % | (- 9,935 m3) |
| • Faturimi - € për | +33.1% | (+ 485,247.93 €) |
| • Arkëtimit -€ për | +24.4% | (+ 332,900.26 €) |
| • Arkëtimi ne % - | - 6.3% | (nga 93.4% në 87.0%) |
| • Shpenzimeve- € për | + 13.9% | (+195,814.47 €) |
| • Rryma elektrike- € për | + 12.9% | (+50,233.75 €) |
| • Pagat- € për | +19.2% | (+155,168.45 €) |
| • UPF- | - 2.7% | (75.1%) |
| • Mbulimi operativ- € | 1.06 | (nga -39,482.72€ në +97,603.07€) |

TM1 -TM2- 2026

- | | | |
|--------------------------|---------|----------------------------------|
| • Prodhimi - m3 për | +1.41% | (+113,663 m3) |
| • Faturimi - m3 për | +8.27 % | (+155,856 m3) |
| • Faturimi - € për | +8.76% | (+ 157,170.87 €) |
| • Arkëtimit -€ për | +2.72% | (+ 45,003.04 €) |
| • Arkëtimi ne % - | - 5.7% | (nga 92.75% në 87.04%) |
| • Shpenzimeve- € për | + 2.54% | (+39,667.12 €) |
| • Rryma elektrike- € për | + 0.09% | (- 400.66 €) |
| • Pagat- € për | +4.43% | (+40,895.87 €) |
| • UPF- | - 1.8% | (75.1%) |
| • Mbulimi operativ- € | 1.06 | (nga +92,267.15€ në +97,603.07€) |

REALIZIMI I CAQEVE TM2-2026

• Prodhimi - m3 për	- 11.32%	(-1,045,339 m3)
• Faturimi - m3 -	- 12.66%	(-295,857 m3)
• Faturimi - € -	- 10.78%	(-235,755.98 €)
• Arkëtimit -€ -	- 21.31%	(-460,209.68 €)
• Arkëtimi ne % -	- 11.35%	(87.0% nga 98.4%)
• Shpenzimeve- €-	- 18.55%	(-364,807.37€)
• UPF-	- 0.4%	(75.1% nga 74.7%)
• Mbulimi operativ- €	-49.43%	(+97,603.07€ nga +193,005.38€)

1.3 Problemet që kanë ndikuar ne realizimin e objektivave

- Niveli i lartë i ujit të pafaturuar, si pasojë e amortizimit të rrjetit, rrjedhjeve të padukshme, matjeve jo të sakta dhe keqpërdorimeve.
- Rritja e kërkesës dhe keqpërdorimi i ujit gjatë temperaturave të larta, që kanë ndikuar në aplikimin e reduktimeve të kontrolluara në Suharekë.
- Ndërprerjet dhe tensioni i paqëndrueshëm i energjisë elektrike, me ndikim në funksionimin e pompave dhe në vazhdimësinë e furnizimit.
- Mosfunksionimi i elektropompës 90 kW në Banjë dhe vështirësitë e furnizimit në zonat e larta të Malishevës, Banjës dhe Carrallukut.
- Dëmtimi i gypit transportues DN315 Senik–Drenoc nga rrëshqitja e dheut dhe nevoja për një zgjidhje të qëndrueshme të këtij segmenti.
- Defektet e shpeshta në rrjetet primare dhe sekondare, veçanërisht pas rritjes së presionit në sistemin e furnizimit nga Stacioni i Banjës.
- Mungesa e eskavatorëve, automjeteve, pompave dhe veglave të nevojshme për reagim të shpejtë të ekipeve operative.
- Numri i madh i ujëmatësve të dëmtuar, të paplombuar ose me qasje të vështirë, si dhe problemet me disa ujëmatës prodhimi dhe zonalë.
- Kapërderdhja e rezervuarëve dhe problemet në sistemet telekomanduese, të ndikuara edhe nga ndërprerjet e energjisë elektrike.
- Rrjeti i vjetruar dhe jashtë standardit në disa zona, i cili vështirëson sanimin dhe rrit humbjet teknike.
- Mbështetja e pamjaftueshme nga disa komuna për projektet infrastrukturore dhe koordinimi jo i plotë ndërinstitucional.
- Azhurnimi jo i plotë i të dhënave dhe mbyllja jo me kohë e aktiviteteve, kërkesave dhe ankesave në platformën MMS.

1.4 Masat e propozuara

- Sanimi i menjëhershëm i defekteve në rrjetin primar dhe sekondar, për zvogëlimin e humbjeve dhe ndërprerjeve.
- Mirëmbajtja e rregullt e stacioneve të pompimit, rezervuarëve, kaptazhave, filtrimit dhe kanalizimit.
- Zgjerimi i zonave DMA, detektimi sistematik i rrjedhjeve dhe menaxhimi i presionit.
- Ndërrimi dhe plumbimi i ujëmatësve, si dhe vendosja e matësve zonalë dhe të prodhimit.
- Rehabilitimi i segmenteve të vjetruara, me prioritet zonat me defekte dhe humbje të shpeshta.
- Optimizimi i pompimit dhe zgjidhja e problemeve energjetike, veçanërisht në Bellanicë.
- Furnizimi i njësive me eskavatorë, automjete, pompa dhe vegla pune.
- Intensifikimi i kontrolleve ndaj lidhjeve ilegale, keqpërdorimeve dhe borxheve.
- Kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë së ujit dhe reagimi në zonat problematike.
- Azhurnimi i GIS-it dhe MMS-it dhe koordinimi me komunat e KEDS-in për projektet prioritare.

2 DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES

2.1 Situata e furnizimit

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijshëm për muajt Prill-Qershor 2026, ka qenë i rregullt në nivel regjional dhe në të gjitha njësitë punuese e operuese. Përfundimisht kanë bërë zonat e larta në njësitë e Suharekës dhe Malishevës, ku është evidentuar mungesë presioni dhe në disa raste, ndërprerje në intervale të shkurtra kohore. Kjo situatë ka ardhur si rezultat i qëndrueshmërisë së burimeve sa i përket sasisë së ujit, rritjes së kapacitetit prodhues, si dhe angazhimit të stafit në sanimin e defekteve në sistemin e furnizimit.

Në krahasim me muajt paraprak, furnizimi në muajt Prill-Qershor 2026, ka qenë i qëndrueshëm mirëpo vlenë të theksohet se ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike kanë ndikuar negativisht në përmbushjen e standardeve optimale të furnizimit 24-orësh me ujë të pijshëm në disa zona. Krahas aktiviteteve të vazhdueshme dhe masave të ndërmarra, si shfrytëzimin e gjeneratorëve si dhe në operim, mirëmbajtje dhe monitorim intensiv të sistemit të ujësjellësit, kemi arritur të sigurojmë furnizim të qëndrueshëm me ujë. Në njësinë e Malishevës ndërprerjet e ujit janë karakterizuar me orare të zgjatura për shkak të defekteve në gypat kryesorë furnizues. Si rezultat i këtyre aktiviteteve është rikthyer furnizimi i rregullt me ujë dhe në cilësi për pije.

Kompania vazhdon të ndërmarrë masa për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës hidroteknike dhe elektro-mekanike, duke synuar sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm dhe cilësor të ujit për të gjithë konsumatorët në zonën e mbulueshmërisë.

Përpjekjet për investime kapitale janë intensifikuar, duke synuar zgjidhjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të problemeve teknike dhe infrastrukturës së vjetër, si dhe menaxhimin efikas të burimeve ujore në kushtet aktuale klimatike.

NJ.P – Prizren

**Furnizimi me ujë:* Ka qenë i qëndrueshëm, furnizim 24/7, në krahasim me muajt paraprak si rezultat i rritjes së nivelit të ujit në burimet kryesore. Reduktimet janë eliminuar në tërësi, të cilat janë aplikuar në disa lagje të qytetit të Prizrenit si dhe në fshatra.

NJ.P- Suharekë

Gjatë muajve Prill-Qershor 2026, furnizimi me ujë ka qenë i qëndrueshëm, ndërprerje të ujit kemi pasur vetëm gjatë intervenimit në rregullimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit në përjashtim të muajit Qershor me rritjen e temperaturave nga mesi i muajit është vërejtur një rritje e ndjeshme e kërkesës për ujë. Gjatë kësaj periudhe, uji nuk është përdorur vetëm për nevoja bazë, por është keqpërdorur në forma të ndryshme, gjë që ka ndikuar negativisht në furnizim.

Për të siguruar një shpërndarje më të drejtë dhe të barabartë të ujit në tërë zonën e shërbimit, nga data 25.06.2026 kemi qenë të detyruar të aplikojmë reduktime të kontrolluara sipas një orari të caktuar.

Reduktimet janë bërë si në vijim: ndërprerje e furnizimit nga ora 19:00 deri në 07:00 në gypin magjstral nga Pusi i Atit deri në Shirokë; në fshatin Gjinoc, Gelanc, Leshan, Terrnje dhe Nepërbisht nga ora 09:00 deri në 17:00; si dhe në rrugën "Garibaldi" në Suharekë dhe në dhe Sallagrazhde nga ora 19:00 deri në 07:00.

NJ.P - Malishevë

* Furnizimi me ujë në njësin tonë ka qenë i mire, por që telashe kemi pas kryesisht me furnizimin e fshatit Drenoc dhe kjo ka ndodhur pasi që nga rrëshqitja e dheut afër pompës së derivateve „Minatori“ është devijuar dhe këputur gypi transportues Senik-Drenoc fi 315mm ndonse terreni i vështirë kemi arritur ta sanojmë defektin por që pas 24h përsëri ka pasur lëvizje dhe se jemi detyruar ta bëjmë edhe një ndërhyrje tjetër në bashkpunim edhe me komunën e Malishevës që na ka mbështetur me një eskavator të madhë është bërë devijimi dhe nxjerrja e gypit perkohësisht mbi dhe deri në një zgjidhje tjetër e që duhet planifikuar edhe buxhet për këtë projekt.

* Pikat e larta përsëri kemi pasur problem furnizimi sikurse muajt paraprak, pasi që elektropompa (90kW nr.2) edhe pse është rregulluar muajin janar, shkurt, mars, prap ka pasur probleme dhe nuk ka funksionuar. Janë bërë disa ndërhyrje por nuk ka përmisim (edhe pse ka garancion 24 muaj), ajo vazhdon edhe sot të mos funksionoi. Nga kjo munges afektohen disa lagje të fshatit Banjë, Malishevë dhe disa lagje të fshatit Carralluk kemi telashe e të cilat janë kryesisht lagjet me lartësi të madhe.

* Siç jeni në dijeni, më 27.04.2026 është vënë në funksion një elektropompë me fuqi 75 kW në Stacionin e Banjës. Vendosija e saj ka përmirësuar ndjeshëm gjendjen e furnizimit me ujë në këtë zonë.

NJ.P - Dragash

* Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt, këtë situatë stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhur, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusëve, eliminimin e defekteve në gypat e ujësjellësit, dhe punë të tjera (pastrime) në kaptazhë në fshatin Radeshë.

2.2 Aktivitetet kryesore

- Angazhimet dhe menaxhimet e përditshme të punëve konform detyrimeve dhe përgjegjësi të vendit të punës dhe jashtë tyre për operimin dhe funksionimin optimal të Departamentit të ujit të pijes në veçanti dhe Kompanisë në përgjithësi.
- Takimet e rregullta ditore, javore e mujore, të menaxhmentit, me bashkëpunëtorët, me udhëheqësat e njësive punuese në varësi dhe shërbimet tjera të Kompanisë.
- Takimet e rregullta javore, së bashku me udhëheqësat e njësive punuese, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në zona të caktuara për zvogëlimin e humbjeve të ujit.
- Takimet me institucionet komunale, qeveritare, institucione financiare donatore, operatorët ekonomik, me konsumatorë, palë tjera të interes, etj.
- Raporti final mujor nga DUP rreth furnizimit, prodhimit, humbjeve të ujit, të dhënat tjera raportuese dhe pasqyra detale e projekteve të realizuara kapitale me mjete vetanake dhe donatore duke evidentuar dhe përshkrimin e statusit të secilit projekt veç e veç.
- Monitorimi dhe menaxhimi profesional i stacioneve e sistemeve elektropompues dhe shërbimeve e furnizimeve për mirëmbajtjen dhe operimin e tyre dhe përpilimi i raporteve.
- Pergaditja e projekteve për inicim dhe implementim, sipas plan-biznesit 2026.
 - Vazhdimi i punimeve në projektin “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjes dhe vendosja e ujëmatësve jashtë prones private në rr. “Kenan Halimi” dhe rruget dytesore në Suharekë.
 - Fillimi i punimeve në projektin “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjes në rrugën Bingeni (Hamit Thaqi) – Prizren”.
- Pergaditja e projekteve kapitale për inicim.
- Shtimi i masave të sigurisë, vizita me të shpeshta në burimet e ujit dhe raportimi për gjendjen e burimeve.
- Monitorimi i 6-DMA zonave në njësitë punuese Prizren, Suharekë dhe Mlishevë.
- Plotësimi dhe dërgimi i të dhënave për realizimin e aktiviteteve në projektin “Resiliencia Klimatike në sektorin e Ujit në Kosovë”.
- Auditim i të dhënave për vitin 2025 nga ARRU.
- Plotësimi i të dhënave të kërkuara nga ARRU.
- Takim me WRIPS, shkëmbim i informatave dhe të dhënave.
- Takim me KFOR-in Britakin, njoftim rreth situatës së furnizimit me ujë.
- Takim në zyrë të ME me komisionin KMNP, dakordim për investimet kapitale.
- Takim me “Komiteti Monitorues për Bashkëpunim dhe Zhvillim”.
- Takim me “Komiteti Monitorues i IPA-s në mes të Kosovës dhe Bashkimit Europian”.
- Takim me KK-Prizren dhe OE, diskutime për finalizimin e projektit “Hartimi i projektit detaj për rritjen e kapacitetit të ujit duke shfrytëzuar burimet Vërmicë dhe Poslisht”.
- Takim me Kryetarin e Komunes së Prizren-it, diskutime rreth investimeve në infrastrukturën e ujit në qytetin e Prizrenit.
- Takim me kryetarin e komunes “Mamushë”, diskutime rreth mundësive për rehabilitimin e rrjetit të ujësjes në komunën e Mamushës.
- Pergaditja e projekt-propozimeve, për dërgim në institucione qeveritare (ME, MI, etj).
- Probleme me kapërderdhjen e rezervuarëve, për shkak të dështimit të sistemit komunikues.
- Monitorim i implementimit të platformës për Operim dhe Mirëmbajtje MMS.
- Implementimi i “Plani i Veprimit për UPF 2026”.

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / TM2- 2026

Njësia Operative	Ujësllësi - uji i pijes
Prizren	521
Suharekë	84
Dragash	40
Malishevë	94
Total	739

Zyra për planifikim dhe zhvillim / Prill-Qershor, 2026

- * Vizita në teren në kuadër të dhënieve të kushteve teknike.
- * Pritimi dhe përgaditja e disa projekteve kapitale për ME (Ministrin e Ekonomisë) - Prishtinë.
- * Plotësimi i të dhënave për vitin 2025, të kërkuara nga ARRU – Të dhënat Për Performancë.
- * Takim me ARRU në zyret e kompanisë – Auditimi i të dhënave të DUP.
- * Plotësimi i të dhënave për vitin 2025, të kërkuara nga ARRU nga Auditimi i të dhënave të DUP.
- * Progresi i Projekteve Kapitale të Ndermarrjeve Publike – WBIF të kërkuar nga ME.
- * Takim me përfaqësuesit e projektit të SUEZIT në zyret e kompanisë.
- * Plotësimi i platëformave ISSHU dhe MMS.
- * Përfundimi dhe pranimi i 4 kopjeve të forta të projektit: "Studimi i fizibilitetit për furnizim me ujë të pijës për Komunën e Malishevës".
- * Vazhdimi i punimeve në projektin: Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësllësit duke përfshirë edhe vendosjen e ujëmatësave jashtë pronës private në rrugët: "BRIGADA 123", "Hajdin Berisha", "Kenan Halimi", dhe "Asllaan Ukë Gashi" në Suharekë.
- * Përgatitja e paramasave të projekteve ideore (projekt-propozimeve) nga KRU "HRJ" për inicim.
- * Pasurimi i GIS-it me infrastruktur të rrjetit të ujësllësit, krijimi i zonave, plotësimi i atributëve përkatëse teknike në GIS dhe MMS, matja e në teren me GPS si dhe vazhdimi i këtyre punëve.

Aktivitetet- TM2- 2026

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti i Ujit të Pijes (DUP)		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajve Prill-Qershor, 2026	
Kalibrim i ujëmatësave	0	riparime të ujëmatësave
Ndërrimi i ujëmatësave (D-M)	481	vizita të konsumatorit
	330	ndërrime të ujëmatësave
	97	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimit të rrjetit	229	detekttime
	153	defekte të gjetura
	10,110	rrjet i detektuar (m)

2.3 Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së – TM2- 2026

Gjatë tremujorit, aktivitetet e Divizionit për UPF janë përqendruar në kontrollin e konsumatorëve në zonat DMA, monitorimin e ujëmatësve, evidentimin e humbjeve dhe detektimin e defekteve në rrjet.

Aktivitetet kryesore në zonat DMA

Zona / Periudha	Aktiviteti kryesor	Rezultati / Gjetjet
DMA Kobaj Prill–Maj	Verifikimi i konsumatorëve dhe përditësimi i të dhënave.	218 konsumatorë të përditësuar; 169 kontrata të nënshkruara; 8 lidhje ilegale të evidentuara.
Maxharrë, Dragobil, Shkozë Prill–Qershor	Kontrolle dhe lexime të ujëmatësve.	Maj: 260 lexime, 168 konsumatorë me konsum zero. Qershor: 257 lexime, 169 konsumatorë me konsum zero (65.75%); humbjet vazhdojnë mbi 70%.
DMA Sallagrazhdë Prill	Kontrolli i ujëmatësve dhe aktivitetet për zvogëlimin e humbjeve.	61 konsumatorë me probleme në ujëmatës; ulje e ujit që hyn në DMA për rreth 20%; rekomanduar zëvendësimi/testimi dhe bllobimi i ujëmatësve.
DMA Dardani Qershor	Verifikim i konsumatorëve dhe kontroll i rrjedhjeve.	125 konsumatorë të verifikuar; 10 rrjedhje në puseta të evidentuara dhe sanuara; problem me qasjen në ujëmatësit e rinj për rreth 95% të konsumatorëve.

Aktivitetet e Ekipit të Detektimit

Aktiviteti	Maj 2026	Qershor 2026	Gjithsej
Kërkesa të shqyrtuara	85	84	169
Defekte të gjetura	53	55	108
Detektme në rrjetin kryesor	17	16	33
Defekte në rrjetin kryesor	15	14	29
Gjatësia e rrjetit të detektuar	3,440 m	3,760 m	7,200 m

Monitorimi, bashkëpunimi dhe raportimi

Aktiviteti	Përmbledhje
Monitorimi dhe raportimi	Monitorim/lexim i ujëmatësve zonalë; raporte mujore për 6 zona DMA dhe raport prodhim/faturim për 44 zona të kompanisë.
DMA Sallagrazhdë	Bashkëpunim me projektin “Rezilienca Klimatike në Sektorin e Ujit në Kosovë”.
DMA Dardani	Bashkëpunim me SUEZ Consulting dhe Bankën Botërore; projekt-propozim për ujëmatës digjitalë dhe ujëmatës të prodhimit.

Çështjet kryesore dhe veprimet prioritare

Çështja	Veprimi prioritar
Konsum i lartë zero dhe humbje të larta në disa DMA	Verifikim i konsumatorëve, kontroll i matjeve dhe intensifikim i detektimit të rrjedhjeve.
Ujëmatës jofunksionale, të pablombuar ose të paqasshëm	Ndërrim/testim i ujëmatësve, bllobim dhe sigurim i qasjes në puseta.
Matje jo e plotë e prodhimit	Përmirësim i matjes dhe instalim i ujëmatësve të prodhimit në zonat prioritare.

2.4 Cilësia e ujit të pijes

- Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në Qytet ,si dhe kontrollimi i klorit në fshatra.
- Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe të puseve të cilat shfrytëzohen për momentin.
- Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorinimit për të percjellur punën e procesit të klorinimit dhe paisjeve.
- Marrja e mostrave sipas Planit për monitorim të cilësisë së ujit.
- Furnizim i stacioneve të klorinimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.
- Riparuar sistemin e klorinimit në Sozi.Me ndihmën e firmës e cila kishte bërë kalibrimin, montimin dhe futjen në sistem të aparaturave.

Analizat bakteriologjike dhe fiziko-kimike nga : IKSH - PRIZREN -TM2- 2026

NJËSIA	LLOJI I UJIT	NR. I MOSTRAVE	NUK I PËRGJIGJEN
PRIZREN	Burim	14	0
	Ujësjellës	461	0
DRAGASH	Burim	1	0
	Ujësjellës	32	0
SUHAREKË	Burim	1	0
	Ujësjellës	68	0
MALISHEVË	Burim	0	0
	Ujësjellës	54	0
KRU	Burim	16	0
	Rrjeti i Ujësjellësit	615	0

TM-2	Lloji furnizimit	Mostra Totali	Bakterologjike			Fiziko-Kimike		
			Nr. Mostrave	Përgjigjet	Nuk përgjigjet	Nr. Mostrave	Përgjigjet	Nr. Mostrave
Prill 2026	Burim	48	24	8	16	24	24	0
	Rrjet	184	92	92	0	92	92	0
Maj 2026	Burim	36	18	10	8	18	18	0
	Rrjet	192	96	96	0	96	96	0
Qershor 2026	Burim	72	36	19	17	36	35	1
	Rrjet	168	84	84	0	84	84	0
Totali	Burim	156	78	37	41	78	77	1
	Rrjet	544	272	272	0	272	272	0

3 DEPARTAMENTI KOMERCIAL

3.1 Aktivitetet kryesore

- Janë zhvilluar takime të vazhdueshme me institucionet komunale, veçanërisht me Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Financave, lidhur me mundësinë e pagesës së faturave të ujit nga Drejtoria e Arsimit për shkollat fillore.
- Me rritjen e temperaturave gjatë muajit qershor është bërë ndryshimi i orarit të punës për ekipet e kontrollit (inspektorët), me qëllim të zbatimit të vendimit të ARRU-së për parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijes për nevoja të tjera.
- Janë angazhuar dy ekipe kujdestarie gjatë ditëve të shtuna, me qëllim të rritjes së inkasimit dhe parandalimit të kyçjeve ilegale në rrjetin e ujësjellësit.
- Janë realizuar thirrje telefonike për të gjithë konsumatorët me saldo deri në 100.00 euro, me qëllim të njoftimit për obligimet e papaguara dhe rritjes së nivelit të inkasimit.
- Ka vazhduar procedura e dërgimit të konsumatorëve debitorë te përmbaruesi privat për arkëtimin e detyrimeve të papaguara.
- Është realizuar legalizimi i konsumatorëve të rinj, duke mundësuar regjistrimin e tyre në sistem dhe përfshirjen në faturimin e rregullt.
- Janë kryer bllobimet e ujëmatësve, në përputhje me procedurat dhe standardet e përcaktuara, me qëllim të parandalimit të ndërhyrjeve të paautorizuara.
- Janë nënshkruar kontrata të reja të shërbimit me konsumatorët, si dhe janë përditësuar kontratat ekzistuese sipas nevojës.
- Janë realizuar aktivitete të vazhdueshme në terren për kontrollin e rrjetit, identifikimin e lidhjeve ilegale, verifikimin e gjendjes së ujëmatësve dhe ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Krahasuar me periudhën paraprake TM-1 performanca e faturimit në TM-2 ka shënuar përmirësim të dukshëm. Faturimi i ujit është rritur nga **1,731,740.66 €** në **1,934,249.10 €**, ose **202,508.44 € (+11.69%)**, si rezultat i rritjes së volumit të faturuar nga **1,885,058 m³** në **2,040,914 m³ (+155,856 m³ ose +8.27%)**. Kjo tregon një rritje të konsumit të faturuar dhe një përmirësim në procesin e leximit dhe faturimit.

Megjithatë, faturimi i të hyrave të tjera ka pësuar rënie të konsiderueshme prej **45,337.57 € (-72.26%)**, duke bërë që rritja e faturimit total të kufizohet në **157,170.87 € (+8.76%)**, pavarësisht performancës së mirë në faturimin e ujit gjithashtu me pezullimin e tarifës së mbi-ngarkesës nga Arru kjo pas ndikim të lartë në të hyrat në këtë kategori.

Në aspektin e inkasimit, inkasimi nga uji është rritur me **77,219.85 € (+4.81%)**, ndërsa inkasimi nga të hyrat e tjera ka rënë ndjeshëm me **32,216.81 € (-66.55%)**. Si rezultat, inkasimi total është rritur vetëm me **45,003.04 € (+2.72%)**, një ritëm dukshëm më i ulët se rritja e faturimit.

Numri i konsumatorëve është rritur nga **65,775** në **66,537**, ose me **762 konsumatorë (+1.16%)**, duke reflektuar zgjerimin e bazës së klientëve. Megjithatë, kjo rritje nuk është shoqëruar me një përmirësim proporcional të arkëtimit.

Një tregues që kërkon vëmendje të veçantë është **ulja e normës së inkasimit nga 92.75% në 87.04%**, pra me **5.71 pikë përqindje**. Kjo tregon se, megjithëse kompania ka faturuar më shumë, ritmi i arkëtimit nuk ka ndjekur të njëjtën dinamikë. Si pasojë, është rritur diferenca ndërmjet shumave të faturuara dhe atyre të inkasuara, duke ushtruar presion mbi rrjedhën e parasë dhe duke rritur potencialisht nivelin e borxheve të papaguara.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë një performancë pozitive në rritjen e faturimit dhe zgjerimin e bazës së konsumatorëve, por një dobësim të efikasitetit të inkasimit. Për periudhën në vijim rekomandohet fokus më i madh në forcimin e mekanizmave të arkëtimit, ndjekjen e konsumatorëve me borxhe dhe rikuperimin e të hyrave të tjera, në mënyrë që rritja e faturimit të reflektohet edhe në përmirësimin e normës së inkasimit dhe të likuiditetit.

3.1.1 Ankesat teknike dhe komerciale

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas kohës dhe prioritetit të tyre

TM2-2026

1. Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	685
1.1 Rrjedhje e ujit	numër	516
1.2 Mungese e ujit	numër	74
1.3 Rënie e presionit	numër	57
1.4 Cilësia e ujit	numër	6
1.6 Të tjera	numër	32
2. Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	221
2.1 Shuma e faturës/Kontestim i Borxhit	numër	146

2.2 Shpërndarja e Faturës/Leximi i ujëmatësit	numër	50
2.3 Te tjera	numer	25
3.Kerkesa Komerciale për Shërbi. e Ujit dhe Kanalizimit	numer	218
3.1 Ndryshim i emrit të konsumatorit - pronës	numer	169
3.2 Pezullim i kontratës/ Pasivizim i faturës	numer	44
3.3 Te tjera	numer	5

3.1.2 Inspektimi dhe Shkyçja

Me intensitet të shtuar , kanë vazhduar kontrollet në teren nga ekipi i inspektimit tek konsumatorët, legalizim te konsumatorëve, ankesa te konsumatorëve, inkasim e borgjeve dhe aktivitete të tjera.

RAPORT I EKIPEVE TË INPEKTORIATIT – TM2- 2026

Njesite operative	Dergimi i verejtjeve	Konsumatorët e legalizuar/ regjistruar	Lidhjet e paligjshme të zbuluara	Nr. i shkyçjeve dhe mos pages	Verifikimi i leximit të ujëmatësve	Lexime të gabuara	Rastet e dorezuar prokuror i/permbirim	Vizita nga ankesat/kerkesat konsumatoreve	Riprogami	Blloime
Prizren	3748	647	124	73	2007	21	157	237	12	353
Suharek	221	93	40	31	4019	15	22	46	1	4
Malishev	52	66	5	18	477	24	33	20	13	28
Dragash	0	88	2	2	129	0	0	6	4	129
HRJ	4021	894	171	124	6632	60	212	309	30	514

4 DEPARTAMENTI I FINANCAVE

4.1 Aktivitetet kryesore

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë.

- Pregatitja dhe ofrimi i dokumentacionit për auditorët e jashtëm. Pranimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm Final si dhe dorëzimi i tij në KKRF;
- Punët ditore të zakonshme, si regjistrimi i arkave në bazë ditore, regjistrimet furnitorëve, depove si dhe aseteve për muajt përkatës.

- Pregatitja e raporteve mujore, tremujore për institucionet përkatëse;
- Hapja dhe pregatitja e pagave për muajin përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punësuarve.
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Pranimi, kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, aprovimi i tyre për blerje dhe shpërndarja e materialit të blerë;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Barazimet e rregullta të arkave mobile me dorëzimin e mjeteve në bankë apo arken kryesore;
- Barazimet e rregullta të furnitorevë, pagesat e rregullta, sipas blerjeve;
- Regjistrimi i investimeve kapitale si dhe raportimi i tyre;
- Regjistrimet ditore në kontabilitet të hyrje/daljeve të materialit në depo;
- Plotësimin e librit të blerjes dhe shitjes sipas kërkesës nga ATK, për muajin përkatës;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;
- Takimet e rregullta me menaxhmentin e kompanisë, lidhur me performancën dhe prezantimin e rekomandimeve për aktivitete të tjera;

4.2.1 Arsyeshmëria e shpenzimeve

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e II-të 2026, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të I-rë 2026 janë për 2.5 % më të larta;

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo rënies së tyre;

- Në pozicionin e pagave kemi një rritje të shpenzimeve të kësaj kategorie në krahasim me tremujorin e kaluar, pasi që në këtë tremujor janë punësuar 8 punëtorë të rinj sipas plan biznesit, gjithashtu janë pensionuar 6 të tjerë dhe si rezultat i punëtorëve të rinj dhe pagesa e tri pagave të fundit që janë dhënë në këtë tremujor për pensionistet, ka ndikuar që shpenzimet për këtë kategori të rriten;
- Ndërsa te pozicioni i energjisë elektrike, kemi një rënie të lehtë të shpenzimeve në krahasim me tre mujorin e kaluar. Krejt këto ndryshime varen nga çmimi i energjisë në treg si dhe hargjimit të pompave varësisht nga nevoja për ujë;
- Ndërsa rritje të lehtë kemi te shpenzimet e derivateve në krahasim me tremujorin e kaluar, pasi që në fund të muajit mars kemi pasur rritjes së çmimit të derivateve në krahasim me tremujorin e kaluar, dhe kjo ka ndikuar në rritje të shpenzimeve të kësaj kategorie;
- Rënie kemi tek pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjes së pompave, në krahasim me tre muajorin e kaluar. Këto shpenzime varen krejt nga numri i defekteve dhe natyra e tyre që mund të ndodhin në rrjetin e ujësjellësit;

- Te shpenzimet e pozicionit të mirëmbajtjes së automjeteve kemi një rritje. Duhet pasur parasysh se në fund të muajit janar kemi nënshkruar kontratë me O.E. për furnizim dhe riparime të automjeteve andaj kjo ka ndikuar që këto shpenzime t'i kemi më të larta, pasi që ka qenë nevoja e madhe për riparime gjë që janë kryer në këtë tremujor;
- Gjithashtu rritje të lehtë kemi pasur te shpenzimet e taksave, për shkak se në këtë tremujor, kemi pasur më shumë lëndë të dërguara tek përmbaruesi, ndërsa shpenzimet e tjera jo pse kanë ndryshuar shumë, si ato të SHUKOS dhe të ARRU-së;
- Te shpenzimet e kategorisë të tjera, kemi rënie të shpenzimeve, pra në këtë kategori ku përfshihen shpenzimet administrative, shpenzimet të jashtme profesionale, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje të softuerit, mirëmbajtje për GPS, shpenzimet e provizioneve, shpenzimet e qiras, gjithashtu këtu hyjnë edhe shpenzimet për veshëmbathje të punëtorëve operativ.

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për këtë tremujor kanë qenë më të larta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyet e cekura me lartë.

10 pagesat me te mëdha nga Hidroregjioni Jugor per Operatoret TM2 2026

NR.	DATA	Document No.	OPERATORI	SHUMA -€
1	5/4/2026	BPBPZNPOS-012163	KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES	168,845.88
2	6/1/2026	BPBPZNPOS-012286	KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES	146,321.47
3	5/20/2026	BPBPZNPOS-012233	K-ING sh.p.k.	88,524.20
4	4/27/2026	PCB-P-00197137	K-ING sh.p.k.	49,264.40
5	5/12/2026	BE-P-00008103	HIDROING SHPK	36,480.00
6	5/6/2026	TEB-SH-000007135	Xerxa Hidro Goup	15,393.60
7	5/26/2026	TEB-SH-000007299	Auto Buqa SH.P.K.	13,075.98
8	6/9/2026	BPBPZNPOS-012324	Auto Buqa SH.P.K.	12,834.00
9	5/4/2026	BPBPZNPOS-012152	Petrol Company	10,878.70
10	4/7/2026	TEB-SH-000006908	KEK - Vërmicë	10,063.84
				551,682.07

10 pagesat me te medha ndaj Hidroregjioni Jugor per TM2 2026

NR	DATA	EMRI I KONSUMATORIT	BANKA	KATEGORIA	SHUMA
1	21.04.2026	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	15,073.47
2	21.05.2026	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	13,601.60
3	08.06.2026	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	12,770.60
4	21.05.2026	SPITALI I QARKUT HEMODIALIZA	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	2,636.26
5	07.04.2026	Rexos Group Shpk	Banka Ekonomike	LOKALET	2,607.26
6	10.04.2026	ASAMBLEJA KOMUNALE-PRIZREN	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	2,564.52
7	18.06.2026	NAMAZGJAH	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	2,358.65
8	20.05.2026	Sh.M"Jetimat e Ballkanit"-Gjinoc	Banka Ekonomike	LOKALET	2,302.17
9	08.06.2026	SPITALI I QARKUT HEMODIALIZA	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	1,936.62
10	26.05.2026	Shadervani-krojet	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	1,881.63

57,732.78

5 DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA

4.1 Aktivitetet e përgjithshme

- Angazhim dhe menaxhim i përditshëm i aktiviteteve që kanë të bëjnë me operim, funksionim dhe optimizim të ITUN-se në Prizren dhe aktivitete të vazhdueshme për konsolidim të Departamentit të Ujërave të Ndotura,
 - Takimet e rregullta të menaxhmentit, takimet virtuale me donatore të huaja dhe vendor, me institucionet komunale, qeveritare, me konsumator, me konsulentat e projektit dhe me kontraktoret etj.,
 - Shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike, harmonizimi i aktiviteteve për ITUN-ne aktuale dhe projektet tjera potenciale të cilat mund të përfitohen në të ardhmen në këtë sektor,
 - Angazhimi si kryetar i komisionit për projektin Rehabilitimi i sistemit të kanalizimit në qytetin e Prizrenit Faza V dhe VI, përmes korrespondencave të vazhdueshme me konsulentin e projektit dhe KfW-ne si agjencion financiar i këtij projekti,
 - Monitorimi, krahasimi dhe aplikimi i testeve të analizave në laboratorin e ITUN-se,
 - Takime të rregullta mujore me stafin aktual të ITUN-se,
 - Procedimi i kërkesave logjistike dhe atyre investive për nevojat e ITUN-se,
 - Vizite në punishte gjatë realizimit të projekteve në baza ditore-Inspektimi i punimeve dhe koordinimi i aktiviteteve,
 - Takim i rregullt mujor me konsulentin SPR&Hidroring dhe kontraktorin Alb Star, me temën Progresi i punimeve për projektin “Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për qytetin e Prizrenit” Faza V dhe VI
-
- Vizite në Impiantin e Ujërave të Ndotura në Bukosh, Njesia Punuese në Suharekë, qëllimi i vizitës Inspektimi në aspektin funksionimit,
 - Dërgimi i kërkesave për takim me kryetarin e Komunes së Prizrenit dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike si dhe dërgimi i Minutave të Takimit si zotim për projektin- investigimin e kolektorit kryesor Dardani-Bellone, deri më tani nuk kemi marrë ndonjë përgjigje zyrtare nga Komuna për datën dhe kohën e takimit,
 - Vizite pune dhe inspektuese e grupeve të operativës me cisternë shtytëse gjatë deblokimit të pusëve dhe sistemit të kanalizimit konform urdhrësive nga konsumatorët.
 - Inspektimi i të gjitha fazave në ITUN, në aspektin e funksionimit si dhe inspektimi në laboratorin e Impiantit në aspektin e mostrimit dhe procedurave të analizave,
 - Dërgimi i të dhënave rreth inputit për Raport të Progresit - kapitulli 27, me kërkesë të KE-se,
 - Dërgimi i minutave të takimit – 03 dhjetor 2025
 - Kërkesë zyrtare për realizimin e vizitës studimore në Impiantin për Trajtimin e Ujërave të Ndotura në Prizren, nga shkolla Mehmet Akif në Prizren,

- Dergimi I te dhenave per ceshtjet kryesore qe duhet te diskutohen gjate takimit me komunitat ne te cilat operon KRU "Hidroregjioni Jugor, me kerese te KE-se,
- Inspektimi nga ARRU per te dhenat e raportuara nga DUN, ne apsketin e besueshmerise te dhenave,
- Vizite ne fshatin Kojush, bashk me ekipet operative eshte bere inspektimi I Injies ne lagjen e eperme te ketij fshati me kerkese nga ana e kosnumatoreve, ku eshte konstatuar se nje segment I kanalziimit duhet te zevendesohet,
- Vizite ne fshatin Dragash, me ekipet operative per marrjen e te dhenave teknike ne teren ne menyre qe te hatohet [rojekti ideor I rrjetit te kanalzimit ne qender te qytetit ne afersi te Gjykates,
- Takim me KE-ne per mundesine e transferimit te Depose se materialit dhe pjeseve fazonike nga Depoja aktuale te lokacioni I Impiantit,
- Dalje ne teren te kompleksi industrial PERLLANKA, per mundesine e zgjidhjes se shkarkimit te ujerave te ndotura,
- Takim me KE-ne, per shyrtimin e kerkeses nga Z.Arwid Holl, per casje ne dokumente zyrtare per projektin "Masat Shoqeruese" I implementuar nga DORSCH, KE eshte sqaruar me rastin e pare te kerkeses nga z. Arwid Holl dhe I eshte derguar pergjigja te cilen KRU HRJ ja ka derguar. Holl. Ne si Departament jemi te gatshem te ofrojme informatat e kerkuara te cilat I posedojme sipas vendimit te KE-se, respektivisht Menaxhmentit te Kompanise.
- Inspektimi I kolektorit kryesor egzistues ne hapesiren industriale te PERLLANKA, bashk me ekipet operative eshte inspektuar kolektori kryesor I cili kolekton ujerat e ndotura per , Perllanke, Printeks dhe Progres ne te cilen aktualisht eshte ndertuar Zona Industriale egzistuese. Per kete kolektor do te perpilohet nje raport I shkurter I cili do ta paraqese gjendjen egzistuese te ketije kolektori.

OPERIMI I I.T.U.N - SË PËR PERIUdhËn TM2- 2026

Uji i trajtuar m3 per TM2-2026

Muaji	Uji ne hyrje m3/muaj	Uji ricirkuluar- m3/muaj	Uji i trajtuar (m3/muaj)
Prill	334,780	83,741	348,704
Maj	346,008	91,328	358,720
Qershor	299,390	94,732	313,706
Total	980,148	269,801	1,021,130

Ndryshimi ne mes te ujit te ndotur ne hyrje dhe ne dalje sipas sistemit SCADA me te cilin matet ne menyre automatike, lejohet deri ne 5.0%, ne rastin tone ky ndryshim eshte 4.0%

Stabilizimi i llumit m3 per TM2-2026

Muaji	Llumi pompuar nga sedimentuesi primar m3/muaj	Llumi pompuar nga sedimentuesi sekondar- m3/muaj	Llumi i deponuar ne shtreter (m3/muaj)
Prill	413	356	19
Maj	451	323	0
Qershor	408	271	0
Total	1,272	950	19

Mirëmbajtja e planifikuar sipas aplikacionit MMS per TM2-2026

Muaji	Trajtimi Mekanik	Trajtimi Biologjik	Trajtimi i Llumit
Prill	210	191	200
Maj	232	197	180
Qershor	158	177	201
Total	600	565	581

Mirëmbajtja emergjente sipas aplikacionit MMS per TM2-2026

